

Permbledhje e joteknike e VNM-se per aktivitetin

“ID .5.10 a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart”.
të subjektit Polyeco Albania sh.p.k



Me vendndodhje: Njesia Administrative Bradashesh, Zona industriale e ish Metalurgjikut ,Elbasan

Maj 2023

Pergatitur nga: A Consultant shpk



Permbajtja

1. Qellimi i ketij dokumenti.....	4
2. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI,.....	9
a. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.	9
Flora& Fauna	9
b. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.	13
3. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;.....	15
a. Uji, akuiferet.....	15
b. Relievi dhe klima.....	17
4. PËRSHKRIM I AKTIVITETIT TE POLYECO ALBANIA.....	19
5. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR; ...	46
a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.	46
b. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.....	46
c. Shkarkimet ne ajer.....	47
d. Zhurmat.	47
e. Fenomene te tjera.	47
f. Gjenerimi i mbetjeve.....	47
g. Ndikime ne biodiversitet.	48
6. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;	48
a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.	48
b. Shkarkimet ne ajer.....	49
c. Zhurmat.	50
h. Fenomene te tjera.....	50
i. Gjenerim i mbetjeve.....	50
7. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;	51
8. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;	51
9. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;.....	Error! Bookmark not defined.

10. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;	52
- Identifikimi i masave zbutese.....	52
- Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.....	55
11. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË);	57
12. SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE DHE PERGJEGJSHMERIA SOCIALE E KOMPANISE.....	58
13. KONKLUZIONE	60
14. Licenca e qkl-së per hartimin e raportit të VNM-së.....	62

1. QELLIMI I KETIJ DOKUMENTI

Polyeco Albania shpk është regjistruar në QKB në datë 03-12-2009 me numër Nipt K92403020S me seli në Rr Dervish Hima, H 1, Apartamenti 28 Tiranë me administrator z Ioannis Karakolis.

Polyeco Albania ka si objekt kryesor aktiviteti menaxhimin e mbetjeve industriale të rrezikshme dhe jo te rrezikshme duke marrë përsipër paketim, transport, magazinim të përkohshëm si dhe trajtim perfundimtar në subjekte të licensuara jashtë territorit të Shqipërisë.

Në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë "Stacion transferimi për mbetje te rrezikshme" me vendodhje Zona industriale e ish Metalurgjikut Bradashesh, Elbasan subjekti Polyeco Albania sh.p.k është paisur me Lejë Mjedisore e tipit III.1.B nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr identifikimi të Lejës 2768 Nr. 2963 Prot., K.Nr.11 dt.13.04.2018 PN-6430-04-2018, Lejë mjedisore e tipit B me Numer PN 0734-08-2010 për "Paketim dhe Transportim i te gjitha llojeve te Mbetjeve Industriale, perfshire edhe Mbetjet e Rrezikshme". dhe me Aktmiratim Mjedisor III.2.B me numër LN-6961-10-2013 për veprimtarinë 'Grumbullim transportim te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme.

Duke marrë parasysh nevojat e tregut dhe industrive të ndryshme që gjenerojnë mbetje industriale të rrezikshme në Shqipëri dhe kapacitetit të kompanisë mëmë POLYECO SA për të trajtuar këto lloj mbetje, subjekti kërkon të shtojë disa kategori mbetjesh për menaxhim, ndryshimi i propozuar nuk ndryshon mënyren e operimit, kapacitetin e impiantit i cili do të mbetet i njëjtë, vendodhjen e impiantit apo kushtet e lejës mjedisore ekzistuese.

Qellimi i aktiviteti te Polyeco eshte qe te ofroj sherbimin e largimit te mbetje jo te rrezikshme ose te rrezikshme nga poseduesit e tyre dhe nga zonat e ndotura per ti derguar ato ne impjante te trajtimit perfundimtar te tyre ne Greqi ose vende te tjera te BE-se. Kete aktivitet kompania synon qe ta afroje ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Kjo permbledhje jo teknike e VNM eshte pergatitur per organizimin e konsultimit me publikun per aktivitetin ID .5.10 a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart”.

Vendndodhja e objektit ku do te kryhet magazinimi I perkoheshem I mbetjeve eshte: Njesia Administrative Bradashesh, Metalurgji Elbasan

- Zona Kadastrale: 3965
- Numri i Pasurise: 18/2 ND
- Siperfaqe e ndertimit: 297,9 m2




Foto 1. Pamje nga ajri e vendodhjes se magazines

Koordinatat ne sistemin Gaus-Kruger sipas sistemit kombetar gjeohapesinor (asig.gov.al) ne tabelen 1.

NR.	Koordinatat Y	Koordinatat X
1	4418555	4552134
2	4418568	4552139
3	4418578	4552115
4	4418565	4512111

Shihni me poshte certifikaten e pronesise te objektit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1319300

Zyra e Regjistrimit _____ ELBASAN _____ Zona Kadastrale Nr. _____ 3965
Numri i Pasurisë _____ 18/2-ND _____ Volumi _____ 6 _____ Faqe _____ 208
Adresa e Pasurisë _____ ELBASAN METALURGJI _____
Lloji i Pasurisë _____ NDERTESE _____
Sipërfaqja Totale _____ 297.9 M2 (dyqind e nentdhjete e shtate pike nente) _____ 297.9
Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
(dyqind e nente dhjete e shtate pike nente)
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
GJERGJI	KRISTO	NITA		ELBASAN

- është pronar i _____ IPASURISE NR 18/2.- ND _____
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V _____ , L _____ , J _____ , P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 24.10.2016 Nr. 12815

Data e lëshimit të çertifikatës

15.11.2016


Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI


(OLTION KOKUNJA)



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

<p>ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME ELBASAN</p> <p>REGJISTRUES Oltion Kokunja</p> <p><i>[Signature]</i> Vula/Firma</p>	<p>A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 3965 NR.PASURISE 18/2-ND VOL. <u>6</u> FO. <u>008</u> INDEKSI I HARTES EL: C-9; D-9 SHKALLA 1:1000 ADRESA E PASURISE: RRETHI ELBASAN Q/F METALURGJI Rr/L "METALURGJI" P/G <u> </u> SH <u> </u> K <u> </u> Ap</p> <p>B. KUFIZIMET V. <u>18/2</u> L. <u>18/2</u> J. <u>18/2</u> P. <u>18/2</u></p> <p>C. PRONARI GJERGJI KRISTO NITA</p> <p>D.DATA <u>11/11/2016</u> ORA.15:00</p> 
---	--



SIPERFAQJA E NDERTESES(NJE KAT)GODINE SHERBIMI=297.9M²

Ing: M. TOLA

Ar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale 3965 NR i PASURISE 18/2. - ND

Indeksi i Hartes EL: C-9,D-9

Adresa e Pasurise : Rrethi ELBASAN Q/F METALURGI

Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

Vol. 6, Fq.

Vijon nga: Vol. , Fq.

Vijon ne: Vol. , Fq. deri ne: Vol. , Fq.

PERFUNDIMTARE (data) : 15/11/2

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurise : NDERTESE Brenda V. k. N. : Jo --- » Po, Ref : _____

Pershkrim i Vecante
SIPERFAQE NDERTIMI
SOC-EKO
297.9 M2

Sip. Totale e Pasurise	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Totale: sa Ndertese	Per pjesen e perbashket:
1. <u>297.9</u> m ² Ref <u>0897</u>	1. _____ m ² Ref <u>0897</u>	1. <u>297.9</u> m ² Ref <u>0897</u>	<u>PALLAT</u> Kuota e Pjesmarrjes: _____ % Nr. i Pasurise (Pallat): _____ Vol. _____, Fq. _____
2. _____ m ² Ref _____	2. _____ m ² Ref _____	2. _____ m ² Ref _____	
3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____	
4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____	

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Registrim	Emri Atesia Mbiemri	Nr. Pasaport	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shurna e Paguar	Data e Lesh. Certifikates	Shenime	Firma
0897	15.11.2016	GJERGJI KRISTO NITA		1	ELBASAN		15.11.2016	LEJE LEGALIZIMI	

2. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI,

a. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.

Zona gjeografike Qarku i Elbasanit ka një sipërfaqje prej 3,278 km² dhe ka një popullsi prej 283,822 banorë. Qendra e Qarkut të Elbasanit ndodhet në qytetin e Elbasanit. Ai përbëhet nga 7 bashki. Bashkia e Elbasanit, Prrenjasit, Librazhdit, Gramshit, Belshit, Cërrikut dhe Peqinit.

Qarku i Elbasanit shtrihet në pjesën lindore të Republikës së Shqipërisë. Ai bën pjesë në Krahinën Malore Qëndrore, dhe ndodhet pothuajse në qendër të saj. Lartësia mesatare e zonës është 1049m mbi nivelin e detit. Kjo lartësi është më e lartë se lartësia mesatare e Republikës. Lumenjtë dhe përrenjtë kryesorë që e përshkojnë këtë rajon janë: Shkumbini, i cili përbën arterien kryesore të rrethit. Rrethi i Elbasanit për vetë pozitën gjeografike që ka dhe karakterin kodrinoro-malor të relievit, ka një klimë me dimër të butë dhe verë të freskët, pasi nëpër të depërtojnë masat ajrore detare, ndërsa malet që e rrethojnë pengojnë depërtimin e masave të ftohta nga lindja.

Zona ku është vendosur aktiviteti është në zonën fushore në afërsi të ish-Metalurgjikut dhe kryesisht ka bime karakteristike të zonës si dhe bime dekoruese. Për sa i përket ekosistemeve dhe habitateve ato shtrihen në disa zona pyjore dhe me shkurre në gjithë territorin e qarkut.

Flora & Fauna

Flora. Një nga komponentët e peisazhit gjeografik i cili ndikon shumë në dukuri dhe procese që ndodhin në të, është edhe bimësia. Në përputhje me faktorët që ndihmojnë në zhvillimin e bimësisë bëhet dhe klasifikimi i saj.

Shumëllojshmëria e madhe e kushteve klimatike dhe e tokave e ka bërë një nga rrethet më të pasur në lloje të shumta bimësh. Megjithatë në zonë mbizotëron bimësia e Europës Qëndrore. Për shkak të relievit kodrinoro-malor, bimësia është e vendosur në kate.

Duke u nisur nga niveli i detit dallojmë këto kate bimore:

Kati i shkurreve meshdetare

Kati i dushqeve

Kati i ahut dhe i halorëve

Kati i kullotave alpine (malore)

Fauna. Pozita gjeografike e rrethit, shumëllojshmëria e peisazheve gjeografike, pasuria bimore, relievi i copëtuar, pasuria ujore dhe veçoritë e klimës kanë përcaktuar një botë të pasur e të shumëllojshme shtazore.

Bota shtazore tokësore përbëhet nga gjitarët (insektngrënësit, mishngrënësit, barngrënësit, zvarranikët etj). Nga gjitarët insektengrënës dallohet urithi, iriqi që gjenden kryesisht në zonën e shkurreve mesdhetare dhe deri në zone e dushkut.

Nga kafshët tokësore, më i përhapuri është lepuri i egër, i cili jeton më tepër në vende të veshura me shkurre dhe pranë tokave bujësore. Derri i egër gjendet më shumë në pyjet e dushkut dhe përdor si ushqim lëndët e lisit. Midis kafshëve të egra grabitqare më të përhapura janë ujku e dhelpra të cilët gjenden pothuajse në të gjithë rrethin. Në vendet malore me pyje të dendura gjendet arriu i murrmë. Kjo kafshë është e rrallë, prandaj gjyjetia e saj është e ndaluar me ligj, ndonëse ajo vazhdon po njësoj. Në rreth janë të përhapura edhe kafshë të tjera si :vjedulla (baldosa), nusja e lalës, ketri, kunadhja, macja e egër etj.

Shumë e pasur dhe interesante është bota e shpendëve, e cila përbëhet përafërsisht nga 250 lloje të ndryshme (të përhershëm si edhe shtegëtarë). Në shpendët grabitqarë dallohen : shqiponja e malit, skifteri, laraska, sorra, bufi, kukuvajka, falkoi etj. Ndër shpendët jo grabitqarë më të përhapur kemi : turtulli, thëllënxa e malit, gjeli i egër, bilbili, mëllenja, qyqja, kumria, qukapiku, grifsha, gushëkuqi, cerri etj.

Po kështu përhapje të gjerë kanë edhe zvarranikët si : gjarpëri, bolla, nëpërka, kakëzogëza etj.

Bota shtazore ujore e rrethit përfaqësohet nga llojet e ndryshme të peshqve, që rriten në ujërat e lumit të Shkumbinit dhe degët e tij si : mlyshi, mustaku, ngjala, trofta, më rrallë edhe vidra. Bota shtazore e rrethit, kohët e fundit është dëmtuar nga gjyjetia e tepruar. Në disa zona ajo është dëmtuar nga përdorimi i pesticideve dhe i lëndëve të tjera shkatërruese.

Megjithatë duhet theksuar se edhe bota shtazore e këtij rrethi përbën një resurs natyror mjaft të pasur i cili ndikon pozitivisht në zhvillimin e turizmit.

Ne qarkun Elbsan gjenden nje sere monumentesh natyrore sipas VKM 676/2002

Rrethi Elbasan

1. Frasheri i Polos Vale
2. Pylli aluvial i Shushices ,
3. Shpella e Leta.nit
4. Hinka e Kosoves (Dumre)
5. Mali (Shkemb) i Gradishtes
6. Shpella e Gracenit
7. Liqenet e Seferanit
8. Liqeni i Deges (Dumre)
9. Burimi i Llixhes se Hibrait
10. Dushku i Lleshanit
11. Meshtekna e Zavalines
12. Pisha e Fushe Kuqes Gjinar
13. Dushku i Kishes Gjinar
14. Listat e Pashtreshit
15. Mani i Zi i Joronishtit
16. Rrepet e Byshekut
17. Robulli i Zeleshnjës
18. Rapi i Bezistanit
19. Rrapi i Vojvodes
20. Rrapi i Gurrese se Labinotit
21. Ulliri i Qejfit
22. Rrapi i Llixhes
23. Rrapi i Uruçës
4. Karsti i Tervalit
5. Kanioni i Holtes
6. Tarraca e Ballares (Qytezes)
7. Gurret e Krushqeve ne Lisec
8. Liqenete Valamares
9. Liqeni i Dushkut
10. Burimet e Kerpices
11. Ujevare e Satires
12. Arra eTunjes
13. Rabullii Valamares
14. Dushkaja e Kater Lisave
15. Moçalet e Graboves
16. Dushku i Bulçarit
17. Ahishtja e Rovjes
18. Liqeni i Zi (Lenie)
19. Geshtenja dhe pisha ne Teqene e Skenderbegasit
20. Rrabull i Graboves

Rrethi Gramsh

1. Shpella e Kabashit
2. Kanioni i Sinecit (Saraselit)
3. Shkemb (kanioni) i Kopaçit (Grabove)

Rrethi Peqin

1. Qarri i Karrines (Drangojve)
2. Bakerima e Garrunjes
3. Vidhi i Tabakut
4. Rrapi i Haskas
5. Rrapi i Uruçajt

6. Lisi i Babaliut

Rrethi Librazhd

1. Meshtekna e Qarishtes
2. Pylli i Stravajt
3. Druri i Bizges
5. Vrima e Sterqokave
6. Shpella e Hasanit
7. Shpella e Shkembit te Bletes
9. Shpella e Kosharishtit
10. Shpella e Pishkashit
11. Shpella e malit te Letmit
12. Sofra e Skenderbeut
13. Burimi i Studnes
14. Gurra e Kosharishtes
15. Liqenet e Rajces
16. Liqeni i Floqit
17. Liqeni i Shebenikut
18. Liqeni i Varrit te Plakes
19. Rrapi i Berzheshtes
20. Rrepet e Gurakuqit
21. Mani i Çupit
22. Rrapi i Hotolishtit
23. Rrapi i Taksimit
24. Rrapi i Gizaveshtit
25. Ahet e Fushe Gurre
26. Pylli i Barkmadhit Kostenje

b. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.

Territori ku ndodhet nuk është në zonat e mbrojtura me ligj sikurse janë: parqet kombëtare, zonat ujore të mbrojtura, zonat mendërtime me vlerë dhe zonat monumentale, të cilat ruhen në përputhje me planet e zhvillimit ekonomik të vendit.

Ne lidhje me pershkrimin e tokave te zones dhe duke u nisur nga lartësitë më të ulta drejt atyre më të larta, dallojmë këto tipe tokash:

- Tokat aluvionale, gjenden në lartësinë 0-500m mbi nivelin e detit. Këto toka janë të pakta.
- Tokat e kafenjta gjenden në lartësinë 600-1000m mbi nivelin e detit. Këto janë toka me shtrirje më të mëdha. Ato formohen mbi shkëmbinjtë sedimentarë dhe pjesërisht mbi shkëmbinjtë magmatikë. Kanë një profil me trashësi deri 120-150cm, përmbajtje të humusit 4-9% dhe reaksion asnjëanës. Në to kultivohen drithërat, duhani, perimet e farogjeret
- Tokat e murrme pyjore shtrihen nga 1000-1200m dhe nga 1600-1800m mbi nivelin e detit. Keto toka formohen nga shkëmbinjtë sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë, kanë profile të trashë (80-140cm), përmbajtje të madhe humusi (rreth 12-15 %), reaksion acid, me përjashtim të rasteve kur zhvillohen mbi gëlqerorët. Janë toka pjellore dhe shfrytëzohen për mbjelljen e disa kulturave bujqësore siç është edhe patatja, thekra, gruri si edhe drurëve frutore, mollëve, kumbullave etj.
- Tokat livadhore malore, shtrihen në lartësitë mbi 1800-2500m mbi nivelin e detit.
- Formohen kryesisht mbi shkëmbinjtë sedimentarë, por ndeshen gjithashtu edhe tek magmatikët apo tek metamorfikët. Këto toka kanë profil me trashësi deri në 1m, dhe dallohen për përmbajtje të lartë humusi (16-24%), për reaksion të theksuar acid, (me prejashitim të rasteve kur zhvillohen mbi gëlqerorët në të cilët marrin reaksion asnjëanës ose pak acid). Janë toka shumë pjellore dhe shfrytëzohen kryesisht si kullota gjatë periudhës së verës



Zona në të cilën zhvillohet ky aktivitet, është një zonë industriale me karakter ekonomik. Sipas studimit urbanistik të PPV miratuar, kjo zonë është konceptuar si hapësirë me investime industriale. Ambjenti është i rrethuar me rrjet dhe mur në perimetrin e tij do të jetë i mbikqyrur me roje sigurie. Objekti do të paiset me system zjarrfikës dhe të gjitha paisjet në rast energjence,

Nga zhvillimi i aktivitetit të subjektit pritet të ketë ndikime në mjedis. Aktiviteti do të zhvillohet teresisht brenda ndërtesës dhe ambjenteve që janë të shtruara me beton dhe që janë sistemuar ndër vite nga subjekti. Meqenëse aktualisht subjekti zhvillon aktivitetin në këtë hapësirë, si rrjedhim të gjitha ndikimet që lidhen me fazën e zënies së sipërfaqes së tokës dhe ndertimin e objektit janë kryer kohë më parë, në fokus të këtij raporti të VNM paraprake do të jenë vetëm ndikimet nga pershtatjet dhe shtesat e rregullimet e ambjenteve dhe të ndërtesës dhe nga funksionimi i aktivitetit. Kështu që në pjesën më poshtë do të analizohen dhe pershkruhen ndikimet e mundshme nga ky aktivitet për pershtatjen dhe modifikimin e mjedisëve gjatë funksionimit të tij.



Foto 2. Pamje nga objektin brenda te cilit do te zhvillohet aktiviteti.

3. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;

a. Uji, akuiferet

Qarku i Elbasanit ka në territorin e tij lumenj, përrenj dhe liqene. Pasuria ujore është një ndër potencialet më të mëdha natyrore që ka ky qark, të cilat kanë impaktin e tyre në shumë proçese jetësore dhe ekonomike. Kjo pasuri ujore kaq e larmishme e qarkut të Elbasanit lidhet me kushtet natyrore shumë të favorshme, në veçanti lidhet me: kushtet klimaterike, veçanërisht sasia e madhe e rreshjeve; relievin, sidomos me praninë e relievit kodrinor dhe malor; kompleksitetin e ndërtimit gjeologjik dhe shumëllojshmërinë e shkëmbinjve (liqenet e Dumresë).

Disa ndër pasuritë ujore më të rëndësishme të qarkut të Elbasanit janë:

- lumi Shkumbin dhe degët e tij (sidomos Qarrishtja, Bushtrica, Gostima dhe Zaranika);
- lumi Devoll dhe degët e tij (sidomos liqeni artificial i Banjës);

- liqenet karstike të Dumresë (84 liqene);
- liqenet akullnajore të Shebenikut (14 liqene);
- ujërat nëntokësore (Ilixhat e Elbasanit);

Ujërat nëntokësore gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës. Cilësia e ujërave nëntokësore nuk është e mirë për të furnizuar banorët me ujë të pijshëm. Ushtrimi i aktiviteteve të propozuar nga subjekti nuk ndikon në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zonës.

Në zonën ku është ndërtuar objekti në jug të tij në një distancë 1,200 m kalon lumi i Shkumbinit. Në afërsi të objektit kalojnë kanal kulluese që mbledhin ujërat e fushës dhe perfundojnë në lumin Shkumbinë. Këto trupa ujorë nuk ndërveprojnë me objektin në fjalë.




Foto 3. Pamje e lumit Shkumbin.

b. Relievi dhe klima

Qarku i Elbasanit nga pikëpamja gjeologjike bën pjesë në trevën e rrudhosur Alpine, që i përket periudhës së 252 milion vjetëve të fundit të historisë gjeologjike të truallit shqiptar. Pothuajse gjithë territori i rrethit bën pjesë në Albanidet e brendshme. Historia e zhvillimit gjeologjik është mjaft e ndërlikuar, si rezultat i një sërë fenomenesh që kanë ndodhur në sipërfaqen e rruzullit tokësor si: faza të ndryshme rrudhosjeje, veprimtaria e vullkaneve, përparimi dhe tërheqja e detit, fundosjet e ngritjet tektonike. Nën veprimin e këtyre forcave të brendshme dhe të jashtme, relievi ka ndryshuar vazhdimisht deri sa ka marrë pamjen e sotme të tij.

Historinë e zhvillimit gjeologjik të rrethit mund ta ndjekim që në erërat paleozoike, sepse dihet që shkëmbinjtë më të vjetër, që formojnë Albanidet, janë formuar gjatë kësaj ere. Gjatë erës paleozoike territori i rrethit ishte i mbuluar nga deti, kjo gjë lejoi që gjatë kësaj kohe të formoheshin shkëmbinjtë sedimentare e magmatike si pasojë e derdhjeve vullkanike nënujorë të formuar në shkëmbinjtë efuzivë.

Prezenca e shkëmbinjve ofiolitike ose “ Gurët e Blertë” tregojnë më së miri se territori i rrethit të Elbasanit gjatë erës paleozoike ka qënë i mbuluar nga deti. Gjatë erës mesozoike dalin mbi ujë viset e para malore të rrethit dhe kryesisht masivi i Shebenikut, vargu i Polisit, Uloku, Golloborda etj.

Në erën kenozoike pothuajse doli mbi ujë gjithë territori i rrethit me përjashtim të luginës së Shkumbinit, e cila gjatë kenozoit ishte mbuluar me dete të brendshëm. Mendohet se nga mesi i periudhës së neogjenit deti i brendshëm mbulonte luginën e Shkumbinit nga Murrashi deri në Qukës dhe pothuajse gjithë pjesën e ulët të luginës. Në vazhdim të zhvillimit gjeologjik, territori i rrethit përfshihet nga lëvizje të fuqishme diferencuese. Kjo gjë solli aktivizimin e erozionit.

Gjatë kuaternarit, si rrjedhim i vazhdimit të lëvizjeve të fuqishme diferencuese lartësia e relievit rritet vazhdimisht. Kjo gjë rriti shumë veprimtarinë gërruese të lumenjve, të cilët krijuan luginat e tyre. Në këtë periudhë në lartësinë e Shebenikut dhe të



Gollobordës filloi veprimtaria e akullnajave, gjurmët e të cilave vërehen edhe sot në formën e luginave apo të cirqeve akullnajore, në Shebenik, Nisur nga pamja e ndërtimit gjeologjik të rrethit, vëmë re se shkëmbinjtë paleozoikë përfaqësohen me terrigjenet që pothuajse gjenden në të gjitha zonat e larta të rrethit, po kështu rreshpet, depozitimet flishore dhe depozitimet molasike gjenden pothuajse në të gjithë rrethin.

Në rreth përhapje të gjerë kanë shkëmbinjtë magmatikë. Ata ndodhen kryesisht në rajonet malore të vendit. Në përgjithësi relievi i formuar prej tyre ka kreshta të rrumbullakta. Ndërsa shkëmbinjtë kenozoikë janë shumë të përhapur dhe përfaqësohen kryesisht nga terrigjenet argjile, ranore, konglomerate, të ndërtuara me shtresa gëlqerorësh, të cilët formojnë pothuajse të gjithë strukturat antiklinale të rrethit. Në këta shkëmbinj pothuajse gjithmonë është zhvilluar procesi i karstit. Grumbullimet kuaternare gjenden kryesisht në zona të ulëta të luginës së Shkumbinit dhe rrëzë maleve të ndryshme të rrethit. Shkëmbinjtë që përbëjnë truallin e rrethit përmbajnë minerale të dobishme. Studimet gjeologjike të kryera në rreth kanë çuar në zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve të ndryshme dhe të shumëllojshme të rrethit, si hekur-nikel, në zonat Prrenjas, Pishkash, Skroskë etj. Apo minerale të rralla të zbuluara në zona të ndryshme të Qarkut si azbesti në Qarrishtë, bokside në Dardhë, Babje etj.

Studimi i klimës ka rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë së rrethit, sidomos për bujqësinë, transportin, për ndërtimet industriale e turistike, për qendrat e banuara etj.

Qarku i Elbasanit për vetë pozitën gjeografike që ka dhe karakterin kodrinoro-malor të relievit, ka një klimë relativisht me dimer të butë pasi nëpër të depërtojnë masat ajrore detare, ndërsa malet që e rrethojnë pengojnë depërtimin e masave të ftohta nga lindja.



Sipas të dhënave nga stacioni i metrollogjik temperatura mesatare e rrethit është 14°C, e përafërt me atë të Çorovodës dhe atë të Gjirokastrës. Muaji më i ftohtë është janari me temperature mesatare 4.4°C, kurse muaji më i nxehtë është gushti me një diferencë të pakët të temperaturave në korrik. Gushti e ka temperaturën mesatare 23.4°C, ndërsa korriku 23.2°C.

Temperatura maskimale absolute e regjistruar është 40.5°C, e shënuar më 14 gusht 1957, kurse temperatura minimale absolute e regjistruar është (-15°C) e regjistruar në 14-15 janar 1968.

Sasia e reshjeve qëndron në vlerat mesatare të Republikës. dhe bien mesatarisht 1.364mm reshje në vit. Muaji më i lagësht është dhjetori me 184mm, shkurti me 174mm. kurse muaji më pak i lagët është korriku me 27mm reshje.

Rreshjet më të mëdha bien në stinën e dimrit, gati 5-herë më shumë se në verë. Maskimumi 24 orësh i rreshjeve është 100mm, regjistruar në 11 janar 1940 dhe më 29 tetor 1939. Rreshjet ketu bien edhe në formë dëbore. Numri i ditëve me reshje në vit është rreth 120. Numri i ditëve me reshje bore është rreth 6.6 ditë me bore në vit. Bora fillon zakonisht në 15-ditëshin e pare të dhjetorit. Lartësia maskimale e shtresës së bores është vërejtur rreth 150cm, si në Shebenik, Kaptinë, Kallkan etj.

Qarku ben pjese ne zonen mesdhetare kodrinore qëndrore, shtrihet kryesisht në të gjithë luginën e Shkumbinit. Karakterisikat e kësaj zone janë: temperaturë mesatare vjetore është 14°C. Temperatura e janarit është 4.4°C, kurse e korrikut shkon në 23.2°C. Temperaturat minimale janë regjistruar deri në (-7°C). Sasia e reshjeve shkon deri në 1.321mm.

4. PERSHKRIM I AKTIVITETIT TE POLYECO ALBANIA

a. Pershkrim i kompanise



Polyeco Albania shpk është regjistruar në QKB në datë 03-12-2009 me numër Nipt K92403020S me seli në Rr Dervish Hima, H 1, Apartamenti 28 Tiranë me administrator z Ioannis Karakolis.

Polyeco Albania ka si objekt kryesor aktiviteti menaxhimit e mbetjeve industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme duke marrë përsipër paketim ,transport ,magazininim të përkohshëm si dhe trajtim perfundimtar në subjekte të licensuara jashtë territorit të Shqipërisë.

Në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë " Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme " me vendodhje Zona industriale e ish Metalurgjikut Bradashesh,Elbasan subjekti Polyeco Albania sh.p.k është paisur me Lejë Mjedisore e tipit III.1.B nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr identifikimi të Lejës 2768 Nr. 2963 Prot., K.Nr.11 dt.13.04.2018 PN-6430-04-2018, Lejë mjedisore e tipit B me Numer PN 0734-08-2010 për "Paketim dhe Transportim i të gjitha llojeve të Mbetjeve Industriale, perfshire edhe Mbetjet e Rrezikshme". dhe me Aktmiratim Mjedisor III.2.B me numër LN-6961-10-2013 për veprimtarinë 'Grumbullim transportim të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme' .

Duke marrë parasysh nevojat e tregut dhe industrive të ndryshme që gjenerojnë mbetje industriale të rrezikshme në Shqipëri dhe kapacitetit të kompanisë mëmë POLYECO SA për të trajtuar këto lloj mbetje, subjekti kërkon të shtojë disa kategori mbetjesh për menaxhim, ndryshimi i propozuar nuk ndryshon mënyren e operimit ,kapacitetin e impiantit i cili do të mbetet i njëjtë, vendodhjen e impiantit apo kushtet e lejës mjedisore ekzistuese.

Polyeco Albania sh.p.k operon ne Shqiperi si dege e Polyeco SA, kompani nderkombetare e licensuar ne fushen e menaxhimit te mbetjeve me qender ne Greqi dhe me deget e saj ne te gjithe Ballkanin.



POLYECO S.A. është lider në Greqi në fushën e Shërbimeve të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nëpërmjet mbledhjes dhe paketimit, riciklimit dhe trajtimit në destinacionin përfundimtar të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Destinacioni përfundimtar është në zonen industriale të Athinës. Fabrika e trajtimit të mbetjeve është me teknologji bashkohore dhe funksionin sipas direktivave të KE në lidhje me parandalimin e integruar të ndotjes dhe kontrollit (IPPC).

POLYECO ofron shërbimin në fushën:

Menaxhimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme dhe të Rrezikshme

- Paketim dhe transport të mbetjeve
- Trajtim përfundimtar të mbetjeve
- Rikuperim/riciklim mbetjesh
- Prodhim i lendeve të para për përdorim industrial
- Analiza kimike

Për të gjitha aktivitetet e saj, Polyeco është e certifikuar me Standartin Ndërkombëtar të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2000, Certifikatën e Sigurisë & Shëndetit ISO 18001 sipas Rregullores Europiane 761/2001/EC për Menaxhim Mjedisor (EMAS). Laboratori për analizimin e kimikateve operon sipas Standartit ELOT EN ISO/TEC 17025:2000.

Gjithashtu Polyeco S.A. disponon Certifikatën për ISO 28000:2007 Menaxhimi i Sigurisë së Zinxhirit të Furnizimit.

Polyeco Albania sh.p.k do të aplikoj për shtimin e kodeve të llojeve të mbetjeve në lejë mjedisore të tipit B ekzistuese për aktivitetin "Paketimin, transportin, magazinimin e mbetjeve industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në të gjithë Republikën e Shqipërisë".



Me autorizim të vecantë do të bëhet eksportimi i këtyre mbetjeve në destinacionin përfundimtar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë konform Konventës së Bazelit për transferimin ndërkufitar të mbetjeve.

Procesi i Menaxhimit i mbetjeve do të përfshijë:

- Karakteristikat e mbetjeve;
- Ndarjen dhe paketimin në venddepozitimet ekzistuese;
- Ngarkim në vendin e depozitimit;
- Verifikim i sistemit për transportin;
- Transportimi i mbetjeve;
- Magazinim të perkohshëm
- Eksportim jashtë vendit me autorizim të veçantë;
- Vend depozitim përfundimtar jashtë vendit;
- Rigjenerim ose asgjесim jashtë vendit;

b. Përshkrimi i aktivitetit

Qëllimi i aktivitetit të Polyeco është që të ofroj shërbimin e largimit të mbetjeve jo të rrezikshme ose të rrezikshme nga poseduesit e tyre dhe nga zonat e ndotura për të dërguar ato në impijante të trajtimit përfundimtar të tyre në Greqi ose vende të tjera të BE-së. Këto aktivitete kompania synon që ta afrojë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Subjekti afroshërbimin e plotë që nga identifikimi, analiza, paketimi, transporti dhe magazinimi i perkohshëm edhe mandej transportin edhe dërgimin e të gjitha llojeve të mbetjeve industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në impijante të trajtimit përfundimtar të tyre. Objekti i kompanisë janë një listë mbetjesh për të cilat kompania ka kontratë për trajtimin e tyre përfundimtar. Lista e mbetjeve jepet në kapitullin 00. Mbetjet që synon të grumbullojë subjekti janë mbetje që krijohen apo



posedohet nga kompani të ndryshme private të cilat krijohen në menyrë periodike gjate aktivitetit te tyre ekonomik, ose jane mbetje te krijuara perpara viteve 90 qe jane stok ose te magazinuara/depozituara ne territoret e ish ndërmarrjeve shtetërore.

Qellimi kryesor i aktivitetit te subjektit eshte qe duke u kujdesur per te grumbullaur edhe larguar mbetjet qe jane objekt i veprimtarise se vet te eshte te kontriboj ne përmiresimin e cilesise se mjedisit, ne zvogëlimin e ndotjes se tokës dhe ndikimeve negative ne ujin nëntokesor dhe në mënyre te veçantë, zvogelimin e konsiderueshem të rrezikut të shendetit publik dhe të komuniteteve te ekzpozuar ndaj mbetjeve.

Mbetjet e krijuara nga zhvillimi i aktiviteve industriale te para viteve 1990, te tilla si uzina e fabrika për prodhimin e kimikateve si dhe mbetjet qe krijohen nga aktiviteti prodhues private mbas viteve 1990, ne mjaft rast kanë shkaktuar degradim serioz të mjedisit ne zonen qe ato jane vendosur. Mbetjet historike apo te reja duke te lena ne mjedis te hapur shpelahen nga reshjet edhe perfundojne duke ndotur token ku jane te depozutara si edhe zonen perreth, trupat uhor siperfaqesor, si edhe ne disa raste edhe ujerat nentokesor. Zonat ne afersi te ketyre ish uzina e fabrika shpeshhere eshte e ndotur edhe perben rrezik te madhe per shendetin e banoreve qe jetojne ne afersi.

Me ane e largimit te ketyre mbetjeve subjektit synon qe te kontriboj në uljen dhe shmangjen:

- (i) E rrezikut te shendetit publik nëpërmjet kontaktit të drejtperdrejte, te kontaktit të rastësishem ose inhalacionit të kimikateve;
- (ii) E rrezikut te mundshëm afat-gjate të ndotjes se tokes;



- (iii) E rrezikut të mundshëm afat-gjate të ndotjes së ujerave nëntokësor nga ndotësit që janë në mbetje, në dherra dhe mbetjet e hedhura në mënyrë të pa kontrolluara;
- (iv) E rrezikut të mundshëm afat-gjate të ndotjes së ujerave sipërfaqësor nga mbetjet e hedhura në mënyrë të pakontrolluara.

c. Përshkrimi i projektit

Kompania jonë ofron zgjidhje në administrimin (mbledhje, paketim, transportim dhe depozitim përfundimtar) të mbeturinave industriale (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) që krijohen nga sektorë të ndryshëm të industrisë.

Subjekti kryen gjithë fazat e procesit të tilla si mbledhja, paketimi, transportimi (ujë, ajër, tokë) të mbeturinave industriale (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) nga territori i Shqipërisë për në destinacione të çertifikuara (fabrika riciklimi, fabrika trajtimi, incenerim etj) jashtë territorit të Shqipërisë. Te gjitha mbetjet që grumbullohen subjekti do të dërgohen në fabrikën e licensuar në Greqi, ose në destinacione përfundimtare (incenerim, trajtim kimik, shkatërrim përfundimtar, riciklim, landfill) të licensuara në vendeve të KE (Komunitetit Europian).

Për të gjitha fazat e procesit të mbledhjes së mbeturinave do të jetë përgjegjës stafi ynë teknik dhe profesional, të cilët bëjnë përcaktimin teknik se si do të procedohet me procesin e mbledhjes, paketimit dhe transportimit të mbeturinave. Të gjitha aktivitetet operacionale do të jenë në përputhje të plotë me Konventën e Bazelit si edhe me Kodet ndërkombëtare IMDG, ADR dhe RID, në bashkëpunim me kompanitë e transportit dhe destinacionet përfundimtare brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



Dorezimi i mbetjeve ne destinacionin përfundimtar te trajtimit te tyre do të shoqërohet gjithashtu me lëshimin e një certificate e cila në mënyrë kronologjike sqaron hapat që në momentin e mbledhjes së mbeturinave deri në destinacionin përfundimtar.

Hapat kryesore te shërbimit te subjektit per menaxhimin e mbetjeve jane:

- 1) Mbledhja e mbeturinave (identifikim, etiketim, paketim),
- 2) Magazinim i perkohshem,
- 3) Transport i sigurte,
- 4) Destinacion perfundimtar / trajtimi ne fabrika të akredituara / licensuara për këtë qëllim.

"POLYECO ALBANIA do të bashkëpunojë vetëm me subjekte të licensuara për administrimin e mbeturinave në Shqiperi dhe në vende të komunitetit europian.

"POLYECO ALBANIA do të bashkëpunojë me POLYECO S.A. në Greqi për eksportin e mbeturinave te mbledhura ne teritorin e Shqiperise per ne fabrikën e saj në Aspropyrgos, Greqi ose me impjante te trajtimiti te mbetjeve ne vende te tjera te komuniteti europian me të cilat bashkëpunon në vazhdimësi. POLYECO S.A. ka një rrjet të gjerë partnerësh në lidhje me fabrikat që bëjnë trajtimet përfundimtare të mbeturinave (incineratorë, landfille për mbetjet e rrezikshme, fiziko-kimik të mbeturinave) dhe do të mbështesë dhe suportojë "Polyeco Albania" në lidhje me lëvizjen ndërkuftare dhe dergimin ne destinacionin përfundimtar te trajtimit te mbetjeve.

d. Proceset kryesore te grumbullimit te mbeturinave

Proceset kryesore te grumbullimit te mbeturinave perfshijne keto faza kryesore te cilat jane kontrolli, identifikimi/klasifikimi.

Kontrolli

Drejtuesi i projektit viziton zonën ku janë të depozituara mbetjet në mënyrë që:



- Të regjistrojë sasinë e mbeturinave.
- Të vlerësojë statusin / kondicionin e tyre ose gjëndjen në të cilën ato ndodhen;
- Të vlerësojë paketimin aktual (nëse ka) dhe të organizoj ripaketimin nëse është e nevojshme;
- Të klasifikojë mbetjet në vendin ku gjenden.

Të dhënat e mbledhura do të përbëjnë bazën e organizimit të paketimit / ripaketimit të mbeturinave dhe transportimit të tyre sipas dhe në përputhje me ADR dhe IMDG.

Identifikimi-Klasifikimi i Mbeturinave

